



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës



Opština Mitrovica - Municipality of Mitrovica

KONTRATA NR.031/2021

Përshkrimi i Kontratës: **Furnizim me PAISJE për Subvencionimin e Fermëve me Mekanizëm Bujqësor-Rotofreza 1.8m gjersi-DBZHR**

NUMRI I PROKURIMIT: 642-21-3639-1-2-1

NUMRI I BRENSHEM : 642/21/031/121

AUTORITETI KONTRAKTUES: **KOMUNA E MITROVICËS**

OPERATORI EKONOMIK: **ANA CO SH.P.K., Mexhit Mustafa, 21010, RAHOVEC**

DATA E NËSHKRIMIT: **16/07/2021**

KONTRATA - Furnizim me PAISJE për Subvencionimin e Fermerve me Mekanizëm Bujqësor-Rotofreza 1.8m gjersi-DBZHR

AUTORITETI KONTRAKTUES: **KOMUNA E MITROVICËS**

dhe

OPERATORI EKONOMIK: **ANA CO SH.P.K., Mexhit Mustafa, 21010, RAHOVEC** TITULLI I KONTRATËS:

Furnizim me PAISJE për Subvencionimin e Fermerve me Mekanizëm Bujqësor-Rotofreza 1.8m gjersi-DBZHR

Nr. i prokurimit ¹	642-21-3639-1-2-1
Nr i brendshëm	642/21/031/121

Neni 1 Lënda

Lëndë e kontratës është Furnizimi dhe montimi, nga operatori ekonomik i punëve në vijim për autoritetin kontraktues:

Furnizim me PAISJE për Subvencionimin e Fermerve me Mekanizëm Bujqësor-Rotofreza 1.8m gjersi-DBZHR

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi i furnizimit me ROTOFREZA sipas specifikacionit në DT është:

Qmimi TOTAL: **44.825.00 €** (Katerdhjetë e katëmiqë e tëtëqindë e njëzete e pesë euro .)

Specifikimi i çmimit të O.E. fitues i bashkangjitet kesaj kontrate.

Kohzgjatja e kesaj kontrate publike është 60 ditë pune ku parashifet afati i LIFERIMI, FURNIZIMI sipas planit te liferimit dhe kërkesave nga ana e Komunës së Mitrovicës (Drejtoria e Bujëqsisë) .

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i vendosur dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

Neni 3 Afatet dhe kushtet e kontratës

Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2, kjo kontratë e ka afatin kohor prej 60 ditë pune dhe kjo kontrollohet nga organi mbiqyres i Autoritetit Kontraktues dhe Menaxheri i kontratës.

Neni 4 Dokumentacioni përbërës dhe plotësues i kontrates sipas prioritetit

Kontrata përbëhet nga dokumentet e mëposhtme, sipas prioritetit:



- Kontrata
- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta,;
- Tenderi i Kontraktuesit,;
- Oferta financiare;
- Kushtet e Përgjithshme;
- Procesverbali i takimit informues/vizita e vendit dhe dispozitat tjera të dosjes së tenderit;

Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose shmangjes, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe/ose Zyrtarit të Prokurimit, nga njëra anë, dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit, dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht sipas nenit 4 në Kushtet e Veçanta.

KONTRATA është e hartuar në gjuhën shqipe në Katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:Komuna- 40000 Mitrovicë	
Emri:	Haxhimet FERATI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	16/07/2021
Vula:	

Për Kontraktorin: ANA CO SH.P.K., Mexhit Mustafa, 21010, RAHOVEC	
Emri:	Ismajl OSA
Emajl	anaco.shpk@gmail.com
Telefoni	+383 45 111 306
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	16/07/2021
Vula:	

KJO KONTRATË ËSHTË PUNUAR NË KATËR KOPJE ORIGJINALE PËR SECILIN PALË
NGA NJË ORIGJINAL

1. Drejtorja e Prokurimit
2. Drejtorja përkatëse e kërkesës Drejtorja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
3. Operatori Ekonomik pala nënshkruese:
4. Drejtorja për Buxhet e Financa

Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në tenderin e tij GJUHA
SHQIPE.

PJESA II E KONTRATES: KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS

PËR KONTRATAT E PUNËVE TË FINANCUARA NGA BUXHETI I KONSOLIDUAR I KOSOVËS DISPOZITAT PRELIMINARE

Neni 1 Përkufizimet

"Kontrata" do të thotë marrëveshje në mes të Autoritetit kontraktues (Punëdhënësit) dhe Operatorit Ekonomik (Kontraktuesit), me të cilën Kontraktori obligohet të kryejë punët e kontraktuara, ndërsa Punëdhënësi obligohet të paguajë shumën sipas marrëveshjes.

"Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat punëdhënësi kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

"Punëdhënësi" është autoriteti kontraktues i caktuar në formën e kontratës, i cili është palë në kontratë dhe duhet ta pranojë punën e mbaruar, për të cilën ai do të paguajë shumën sipas kontratës.

"Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

"Kontakt personi" është njeriu i caktuar në formularin e kontratës, i cili është i autorizuar nga punëdhënësi të mbajë kontakte me Kontraktuesin.

"Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Punëdhënësi), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Punëdhënësit. (DSHPI)

"Grupi i operatorëve ekonomik" është asociacion i personave fizikë dhe juridikë apo një grupi të bashkuar, që kanë bërë marrëveshje për kryerjen e punës në tërësi apo një a më shumë pjesësh të punëve të caktuara.

"Tenderi i Kontraktuesit" është dokumentacioni i plotë i dorëzuar si përgjigje ndaj ftesës së autoritetit kontraktues për tender brenda afatit kohor të saktësuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dosjen e Tenderit.

"Specifikacioni" do të thotë specifikime (përshkrime) teknike të punëve të përfshira në kontratë si dhe të gjitha ndryshimet e bëra apo shtesat e miratuara nga punëdhënësi.

"Çmimi Kontratës" do të thotë shuma sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

"Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

"Ditët" janë ditët kalendarike

"Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

"Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga punëdhënësi për kryerjen e punëve të kontraktuara.

"Defekte" janë pjesët e papërfunduara të punëve e që është dashur të kryhen sipas kontratës.

"Ndodhitë e zhdëmtuara" janë ato që janë përkufizuar në nenin 21 të këtyre kushteve të përgjithshme të kontratës.

"Forca madhore" është ngjarje apo rrethanë që e ka bërë të pamundur realizimin ose përmbushjen e kontratës nga ndonjëra palë, që ka ndodhur pa fajin e palëve në kontratë dhe që nuk ka mundë të parashikohet a parandalohet.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 Kushtet e veçanta e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e procedurës.

Neni 3 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

- 3.1 Përveç nëse është dhënë ndryshe në Kushtet e veçanta, kontrata përbëhet nga këto dokumente, të renditura sipas përparësisë:
- marrëveshja e kontratës;
 - Kushtet e veçanta me aneksin teknik;
 - Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë anekset;
 - Specifikimet financiare (Aneksi III) ;
 - kushtet e përgjithshme (Aneksi I);
 - [procesverbali i takimit informues/vizitës në vend];
- 3.2. Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën do të konsiderohen se shpjegojnë njëra tjetrën, në rastet e paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit në të cilin janë paraqitur më sipër.

Neni 4 Komunikimet

- 4.1 Komunikimet ndërmjet Autoritetit kontraktues nga njëra anë, dhe Kontraktuesit nga ana tjetër, do të jenë ekskluzivisht në formë të shkruar. Përveç nëse saktësohet ndryshe në Kushtet e veçanta, komunikimet ndërmjet Autoritetit kontraktues nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër, do të dërgohen me postë, faks, e-mail , ose të dorëzohen personalisht sipas nenit 4 në Kushtet e veçanta.
- 4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.
- 4.3 Sa herë që kontrata mundëson dhënien apo lëshimin e ndonjë njoftimi, pranimi, aprovimi, certifikate apo vendimi, përveç nëse është specifikuar ndryshe, ky njoftim, pranim, aprovim, certifikatë apo vendim do të jenë me shkrim dhe fjalët "njoftoj", "certifikoj", "aprovoj" ose "vendos" duhet të ndërtohen sipas rrethanave. Të gjitha pranimet, aprovimet, certifikatat apo vendimet e tilla nuk do të mbahen ose të vonohen pa arsye.

Neni 5 Transferimi

- 5.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 5.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
- kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të parave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
 - në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguresve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.
- 5.3 Për qëllimet e nenit 5.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 5.4 Nëse Kontraktuesi e ka transferuar kontratën e tij pa autorizim, Autoriteti kontraktues mundet që, pa dhënë njoftim zyrtar paraprak, të zbatojë sipas të drejtës sanksionet për shkelje të kontratës që janë dhënë nën nenin 35.
- 5.5 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për transferim të kontratës.

Neni 6 Nën-kontraktimi

- 6.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës së kontratës.
- 6.2 Kontraktuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 5 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.
- 6.3 Nënkontraktuesit duhet t'i përmbushin kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënie të kontratës, si dhe kriteret tjera të specifikuara në dosjen e tenderit që janë të nevojshme për ekzekutimin e nënkontratës.

- 6.4 Autoriteti kontraktues nuk njihet lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.
- 6.5 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.
- 6.6 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me Punët që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 7 Dhënia e dokumenteve

- 7.1 Nëse është e nevojshme, brenda [30] ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Kontraktuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.
- 7.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.
- 7.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.
- 7.4 Kushtet e veçanta duhet të tregojnë, nëse ka nevojë, procedurën e përdorur nga Autoriteti kontraktues për aprovimin e skicave dhe dokumenteve tjera të dhëna nga Kontraktuesi.

Neni 8 Ndhurma lidhur me rregulloret vendore

- 8.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të vendit ku do të jepen Punët dhe të cilat mund të ndikojnë te kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Kontraktuesi me shpenzime të Kontraktuesit.
- 8.2 Nëse është e nevojshme, Kontraktuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi Punët ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuara ose licencat e importit.
- 8.3 Nëse është e nevojshme, Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë, në pajtim me Kushtet e veçanta, lejet e kërkuara apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.
- 8.4 Sipas dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën e jashtme në vendet në të cilat do të dorëzohen Punët, Autoriteti kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet për t'i ndihmuar Kontraktuesit që t'i marrë të gjitha vizat dhe lejet që kërkohen për personelin punët e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsiderojnë si të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 9 Obligimet e përgjithshme

- 9.1 Kontraktuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin në vend, ngritjen, testimin dhe komisionimin e Punëve dhe realizimin e punëve tjera duke përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në Punë. Kontraktuesi do të sigurojë edhe pajisjet, mbikëqyrjen, punën dhe lehtësirat e duhura për realizimin e kontratës.
- 9.2 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda [30] ditësh pas pranimit të urdhrimit. Ekzekutimi i urdhrimit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.
- 9.3 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në vendin e Autoritetit kontraktues dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve. Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat dhe procedurat që mund të shfaqen nga ndonjë shkelje e ligjeve dhe

rregulloreve të tilla nga ana e Kontraktuesit, punëtorëve të tij dhe të varurve të tyre .

- 9.4 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalojë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Nëse shfaqet ndonjë mosmarrëveshje lidhur me nevojën për publikim ose shpalesje për qëllime të kontratës, vendimi i Autoritetit kontraktues do të jetë final.
- 9.5 Nëse Kontraktuesi është ndërmarrje e përbashkët ose konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës sipas ligjit të shtetit të Autoritetit kontraktues dhe me kërkesë të Autoritetit kontraktues, do të caktojë një nga këta persona që të veprojnë si udhëheqës përkritazi me autoritetin, për ta obliguar ndërmarrjen e përbashkët apo konsorciumin. Përbërja e ndërmarrjes së përbashkët ose konkorciumit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

Neni 10 Prejardhja

- 10.1 Kontraktuesi do të paraqesë një certifikatë zyrtare të prejardhjes së Punëve në momentin e pranimit të përkohshëm. Nëse ky obligim nuk plotësohet, kjo do të çojë në ndërprerje të kontratës, me paralajmërim zyrtar.

Neni 11 Siguria e ekzekutimit

- 11.1 Kontraktuesi, brenda [30] ditësh nga pranimi i njoftimit të dhënies së kontratës, i jep Autoritetit kontraktues një siguri për ekzekutimin e plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në Kushtet e veçanta. Ajo duhet të jetë e barabart me së paku 10% të shumës së çmimit të kontratës, duke përfshirë edhe shumat e parapara në shtesën e kontratës. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.
- 11.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën VI të kontratës dhe mund të jepet në para të gatshme apo formë të ngjashme, në formë të një çeku të vërtetuar, letër krediti ose garancion bankar.
- 11.4 Siguria e ekzekutimit do të jetë në Euro. Asnjë pagesë nuk do të bëhet në favor të Kontraktuesit para dhënies së sigurisë. Siguria do të vazhdojë të jetë valide derisa kontrata të jetë realizuar plotësisht dhe në mënyrën e duhur.
- 11.5 Gjatë ekzekutimit të kontratës, nëse personi fizik ose juridik që e jep sigurinë nuk është në gjendje t'i mbajë zotimet e veta, siguria nuk do të jetë më valide. Autoriteti kontraktues do të japë njoftim zyrtar për Kontraktuesin për të dhënë një siguri të re me të njëjtat kushte si ajo e mëparshme. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të japë një siguri të re, Autoriteti kontraktues mund ta ndërpresë kontratën. Para se ta bëjë këtë, Autoriteti kontraktues do të dërgojë një letër të regjistruar ku pohon pranimin, dhe në të cilën do të vendoset një afat i ri prej jo më pak se 15 ditësh nga dita e dorëzimit të letrës.
- 11.6 Autoriteti kontraktues do të kërkojë pagesë nga siguria e të gjitha shumave, për të cilat është i detyruar garantuesi, në rast të shkeljes së kontratës nga ana e Kontraktuesit, në pajtim me kushtet e sigurisë dhe deri në vlerën e saj. Garantuesi, pa vonesë do t'i paguajë ato shumat pas kërkesës së Autoritetit kontraktues dhe nuk mund të paraqesë asnjë kundërshtim për asnjë arsye. Para se të bëhet ndonjë pagesë nga siguria e ekzekutimit, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin duke paraqitur natyrën e shkeljes lidhur me të cilën do të bëhet tërheqja nga siguria.
- 11.7 Përveç asaj pjese të specifikuar në Kushtet e veçanta lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda [30] ditësh nga lëshimi i certifikatës finale të pranimit.]

Neni 12 Sigurimi

- 12.1 Mund të kërkohet polisa e sigurimit për të mbuluar bartjen e Punëve; kushtet e kësaj polise të sigurimit mund të saktësohen në Nenin 12 të Kushteve të veçanta, ku mund të saktësohen edhe lloje tjera të sigurimit që do t'i marrë Kontraktuesi.
- 12.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Kontraktuesit sipas Nenit 12.1, Kontraktuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Kontraktuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

Neni 13 [Programi i realizimit]

- 13.1 Nëse kërkohet në Kushte, Kontraktuesi do të dorëzojë një program të realizimit të kontratës që do të aprovohet nga autoriteti kontraktues. Ky program do të përmbajë së paku këto:
- a) rendin sipas të cilit Kontraktuesi propozon të realizohet kontrata, duke përfshirë dizajnin, prodhimin, dorëzimin në vend të pranimit, instalimin, testimin dhe komisionimin;
 - b) afatet e fundit për dorëzim dhe aprovim të skicave;
 - c) një përshkrim të përgjithshëm të metodave të cilat Kontraktuesi propozon t'i përdorë për ekzekutimin e kontratës; dhe
 - d) të dhëna dhe informata të tjera të cilat mund t'i kërkojë me arsye autoriteti kontraktues.

- 13.2 Kushtet e veçanta do të saktësojnë limitin kohor brenda të cilit programi i realizimit duhet t'i dorëzohet për aprovim autoriteti kontraktues. Në to mund të vendosen limitet kohore brenda të cilave Kontraktuesi duhet të dorëzojë të gjitha ose një pjesë të skicave të detajuara, dokumenteve dhe objekteve. Në to do të theksohet edhe afati kohor për aprovimin e autoritetit kontraktues apo pranimin e programit të realizimit, skicat e detajuara, dokumentet dhe objektet. Aprovimi i programit nga autoriteti kontraktues nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.
- 13.3 Asnjë ndryshim material në program nuk mund të bëhet pa aprovimin e autoritetit kontraktues. Megjithatë, nëse progresi i realizimit të kontratës nuk bëhet sipas programit, autoriteti kontraktues mund ta udhëzojë Kontraktuesin që ta ripunojë programin dhe ta dorëzojë programin e ripunuar për aprovim të ai.]

Neni 14 Skicat e Kontraktuesit

- 14.1 Nëse mundësojnë Kushtet e veçanta, Kontraktuesi do t'i dorëzojë autoritetit kontraktues për aprovim:
- a) skicat, dokumentet, mostrat dhe/ose modelet, sipas afateve kohore dhe procedurave të paraqitura në Kushtet e veçanta;
 - b) skicat që autoriteti kontraktues mund të kërkojë me arsye për realizimin e kontratës.
- 14.2 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ta lajmërojë vendimin e vet të aprovimit të cekur në Nenin 14.1 brenda afatit kohor të dhënë në kontratë ose programin e aprovuar të realizimit të kontratës, skicat, dokumentet, mostrat ose modelet e tilla do të konsiderohen si të aprovuara pas kalimit të afatit të fundit. Nëse nuk saktësohet asnjë afat, ato do të konsiderohen si të aprovuara [30] ditë pas pranimit.
- 14.3 Skicat, dokumentet, mostrat dhe modelet e aprovuara do të nënshkruhen ose do të identifikohen në ndonjë mënyrë tjetër nga autoriteti kontraktues dhe nuk mund të merren parasysh vetëm me udhëzimin e autoritetit kontraktues. Të gjitha skicat, dokumentet, mostrat ose modelet e Kontraktuesit të cilat autoriteti kontraktues nuk arrin t'i aprovojë do të modifikohen menjëherë për t'i plotësuar kërkesat e autoritetit kontraktues dhe të dorëzohen prapë te Kontraktuesi për aprovim.
- 14.4 Kontraktuesi do të dorëzojë kopje tjera të skicave të aprovuara në formën dhe numrat e dhëna në kontratë ose në rendin pasues administrativ.
- 14.5 Aprovimi i skicave, dokumenteve, mostrave apo modeleve nga autoriteti kontraktues nuk e liron kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.
- 14.6 Autoriteti kontraktues ka të drejtë t'i inspektojë të gjitha skicat, dokumentet, mostrat dhe modelet që kanë të bëjnë me kontratën në objektin e Kontraktuesit në çfarëdo momenti të arsyeshëm.
- 14.7 Para pranimit të përkohshëm të Punëve, Kontraktuesi do të japë manualët e operimit dhe të mirëmbajtjes bashkë me skicat, të cilat do të jenë aq në detaje sa t'i mundësojnë autoritetit kontraktues që të operojë, mirëmbajë, përshtatë dhe riparojë të gjitha pjesët e Punëve. Përveç nëse është thënë ndryshe në Kushtet e veçanta, manualët dhe skicat do të jenë në gjuhën e kontratës dhe në forma dhe numra të tillë ashtu si janë dhënë në kontratë. Punët nuk do të konsiderohen si të plota për qëllim të pranimit të përkohshëm derisa këto manuale dhe skica t'i jenë dhënë Autoritetit kontraktues.

Neni 15 Mjaftueshmëria e çmimeve të tenderit

- 15.1 Nën dispozitat që mund të paraqiten në Kushtet e veçanta, Kontraktuesi do të konsiderohet se është i kënaqur para se ta dorëzojë tenderin e tij për sa i përket saktësisë dhe mjaftueshmërisë së ofertës dhe që ka marrë parasysh të gjitha që kërkojnë për realizim të plotë dhe të duhur të kontratës, dhe që ka përfshirë në normat dhe çmimet e tij të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me Punët, veçanërisht:
- a) Koston e transportit;
 - b) Koston e mbikëqyrjes, paketimit, ngarkimit, shkarkimit, tranzitit, dorëzimit, shpaketimit, kontrollimit, sigurimit dhe kosto tjera administrative lidhur me Punët. Paketimi do të jetë pronë e Autoritetit kontraktues përveç nëse parashihet ndryshe në Kushtet e veçanta;
 - c) Koston e dokumenteve që kanë të bëjnë me Punët në rastet kur këto dokumente kërkojnë nga Autoriteti kontraktues;
 - d) Realizimin dhe mbikëqyrjen e montimit në vendin e duhur dhe/ose komisionimin e Punëve të dorëzuara;
 - e) Shërbimin me veglat e nevojshme për montim dhe/ose mirëmbajtje të Punëve të dorëzuara;
 - f) Shërbimin me manuale detaje të operimit dhe të mirëmbajtjes së secilës njësi të Punëve, siç është specifikuar në kontratë;
 - g) Mbikëqyrjen ose mirëmbajtjen dhe/ose riparimin e Punëve, për një periudhë kohore të dhënë në kontratë, duke paraparë që këto punë nuk do ta lirojnë Kontraktuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës;
 - h) Trajnimin e personelit të Autoritetit kontraktues, në fabrikën e Kontraktuesit dhe/ose diku tjetër siç është specifikuar në kontratë.
- 15.2 Pasi që Kontraktuesi konsiderohet se ka përcaktuar çmimet e tij në bazë të llogaritjeve të veta, në operime dhe vlerësime, ai, pa pagesë plotësuese, do të realizojë punët që janë subjekt i ndonjë pike në ofertën e tij për të cilin ai

nuk tregon as çmimin për njësi dhe as shumën e plotë.

Neni 16 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

- 16.1 Që Punët të importohen në vendin e Autoritetit kontraktues, duhet të përfshihen të gjitha pagesat dhe tatimet e zbatueshme për importimin e tyre, duke përfshirë edhe TVSH.
- 16.2 [Cilado qoftë prejardhja e mallit të furnizuar, kontrata do të çlirohet nga detyrimet mbi vulën dhe regjistrimin.]

Neni 17 Patentat dhe licencat

- 17.1 Përveç në rastet kur është paraparë ndryshe në Kushtet e veçanta, Kontraktuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

FILLIMI I EKZEKUTIMIT DHE VONESAT

Neni 18 Rendi i fillimit

- 18.1 Autoriteti kontraktues do ta fiksojë datën në të cilën do të fillojë realizimi i kontratës dhe ta lajmërojë Kontraktuesin për këtë ose në njoftimin e dhënies së kontratës ose përmes urdhrat administrativ që lëshohet nga autoriteti kontraktues.
- 18.2 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, realizimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se [90] ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Kontraktuesi do të ketë të drejtë të mos e realizojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Kontraktuesit do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda [30] ditësh pas skadimit të periudhës [90]-ditore.

Neni 19 Periudha e ekzekutimit të detyrave

- 19.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e fiksuar në pajtim me Nenin 18 dhe do të jetë siç është thënë në kontratë, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 20.
- 19.2 Nëse mundësohen periudhat e ndara të realizimit për sasi të ndara, këto periudha nuk do të mbliidhen në rastet kur një Kontraktuesi i jepën më shumë se një sasi.

Neni 20 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

- 20.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritët se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:
- a) Autoriteti kontraktues porositi Punë ekstra ose plotësuese;
 - b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e Punëve;
 - c) Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e Punëve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një kontraktues kompetent;
 - d) Urdhra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të kontraktuesit;
 - e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
 - f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të Punëve që nuk janë për shkak të gabimit të Kontraktuesit;
 - g) Forca madhore;
 - h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Kontraktuesit.
- 20.2 Brenda [15] ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda [30] ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.
- 20.3 Brenda [30] ditësh, me njoftim me shkrim për kontraktuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 21 Vonesat e ekzekutimit

- 21.1 Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha punët ose të realizojë punët brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, ose [5/100] të vlerës së Punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.
- 21.2 Nëse mosdorëzimi i punëve parandalon përdorimin e zakonshëm të Punëve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 21.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të kontratës.
- 21.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku [10 %] të vlerës së kontratës ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Kontraktuesin:
- të konfiskojë garancinë e realizimit;
 - të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
 - të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie e pjesës së mbetur të Punëve. Kontraktuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

Neni 22 Variacionet

- 22.1 Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën që, në kohën e kontraktimit, t'i ndryshojë sasinë e parapara në Kushtet e veçanta. Vlera totale e furnizimeve mund të mos rritet dhe as të bjerë si rezultat i variacionit të sasive për më tepër se [10 %] të çmimit të kontratës.

Çmimet e njësisë që janë përdorur në ofertë do të zbatohen edhe për sasinë e prokuruar me variacion.

- 22.2 Autoriteti kontraktues do të ketë fuqinë për të porositur ndonjë variacion për ndonjë pjesë të Punëve të nevojshme për plotësimin e duhur dhe/ose funksionimin e Punëve. Këto variacione mund të përfshijnë shtime, lënie anash, ndërrime, ndryshime të cilësisë, sasisë, formës, karakterit, llojit si dhe të skicave, dizajneve ose specifikimeve ku Punët do të prodhohen në mënyrë specifike për Autoritetin kontraktues, metodën e transportimit ose paketimit, vendin e dorëzimit, dhe në rendin e specifikuar, metodën ose kohën e ekzekutimit të Punëve. Asnjë urdhër për variacion nuk duhet të ketë si rezultat që kontrata të bëhet e pavlefshme, por efekti financiar i të gjitha variacioneve të tilla do të vlerësohet në pajtim me Nenin 22.6.
- 22.3 Nuk duhet të bëhet asnjë variacion përveç nëse bëhet me urdhër administrativ, dhe me kushtet e mëposhtme:
- a) Nëse, për ndonjë arsye, autoriteti kontraktues beson se është e nevojshme të japë një urdhër gojarisht, ai do ta konfirmojë
 - b) urdhrin me një urdhër administrativ sa më shpejt që të jetë e mundur;
 - c) Nëse Kontraktuesi konfirmon me shkrim një urdhër të dhënë gojarisht për qëllime të Nenit 22.3.a dhe konfirmimi nuk kundërshtohet me shkrim nga autoriteti kontraktues, konsiderohet se është lëshuar urdhri administrativ për variacion;
 - d) Urdhri administrativ për variacion nuk do të kërkojë atëherë kur rritet ose zvogëlohet sasia e Shërbimit për shkak se vlerësimet në faturën e sasive ose ndarja e buxhetit kanë qenë tepër të larta ose tepër të ulëta.
- 22.4 Përveç nëse Neni 22.2 parasheh ndryshe, para se të lëshohet urdhri administrativ për variacion, autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin për natyrën dhe formën e atij variacioni. Sa më shpejt që të jetë e mundur, pas pranimit të këtij njoftimi, Kontraktuesi do t'i dorëzojë autoritetit kontraktues një propozim që përmban:
- Një përshkrim të detyrave, nëse ka, që do të realizohen ose të masave që do të merren dhe një program të realizimit;
 - Ndonjë modifikim të nevojshëm të programit të realizimit ose të ndonjë obligimi të Kontraktuesit sipas kontratës;
 - Ndonjë korigjim të çmimit të kontratës në pajtim me rregullat e paraqitura në Nenin 22.
- 22.5 Pas pranimit të dorëzimit të Kontraktuesit që është përmendur në Nenin 22.4, autoriteti kontraktues, do të vendosë sa më shpejt që është e mundur nëse duhet të realizohet variacioni ose jo. Nëse autoriteti kontraktues vendos që variacioni duhet të realizohet, ai do të lëshojë një urdhër administrativ që thotë që variacioni do të bëhet me çmimet dhe sipas kushteve të dhëna në dorëzimin e kontraktuesit të përmendur në Nenin 22.4 ose të modifikuar nga autoriteti kontraktues në pajtim me Nenin 22.6.
- 22.6 Çmimet e të gjitha variacioneve që janë kërkuar nga autoriteti kontraktues në pajtim me nenet 22.3 dhe 22.5 do të vërtetohen nga autoriteti kontraktues në pajtim me këto parime:
- Nëse detyra ka karakter të ngjashëm dhe është ekzekutuar nën kushte të ngjashme me një artikull që i është dhënë çmimi në faturën e sasive ose në ndarjen e buxhetit, ajo do të vlerësohet në ato norma dhe çmime që ndodhen në ato

dokumente;

- Nëse detyra nuk është e karakterit të ngjashëm ose nuk ekzekutohet nën kushte të ngjashme, atëherë normat dhe çmimet në kontratë do të përdoren si bazë për vlerësim përdorues të jenë të arsyeshme, dhe përndryshe do të bëhet një vlerësim i drejtë nga autoriteti kontraktues;
 - Nëse natyra ose shumica e ndonjë variacioni të afërt me natyrën ose çmimin e tërë kontratës ose të ndonjë pjese të saj është e tillë që, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, të gjitha normat ose çmimet që i përmban kontrata për cilëndo pikë të punës për shkak të variacionit të tillë konsiderohet si e paarsyeshme, atëherë autoriteti kontraktues do ta fiksojë atë normë ose çmim në atë mënyrë që ai mendon se është e arsyeshme dhe e duhur në ato rrethana;
 - Në rastet kur një variacion është i nevojshëm për shkak të një gabimi ose shkeljeje të kontratës nga ana e Kontraktuesit, të gjitha kostot plotësuese që i përkasin këtij variacioni do t'i bartë Kontraktuesi.
- 22.7 Pas pranimit të urdhrit administrativ që e kërkon atë variacion, Kontraktuesi do të vazhdojë ta realizojë variacionin dhe të jetë i obliguar me atë urdhër që të veprojë njësoj si variacioni i tillë të jetë i paraparë në kontratë. Punët nuk do të vonohen duke pritur dhënien e ndonjë zgjatjeje të kohës për përfundim ose për përshtatje ndaj çmimit të kontratës. Në rastet kur urdhri për variacion i paraprin përshtatjes së çmimit të kontratës, Kontraktuesi do të mbajë regjistrat e kostos së ndërmarrjes së variacionit dhe kohës së harxhuar në këtë. Këto regjistra do të jenë të hapur për inspektim nga autoriteti kontraktues në çdo kohë të arsyeshme.
- 22.8 Variacionet e kontratës që nuk janë mbuluar me urdhër administrativ duhet të zyrtarizohen përmes një suplementi në kontratë, të nënshkruar nga të gjitha palët. Ndryshimet e adresës ose të llogarisë bankare mund të njoftohen thjeshtë me shkrim nga Kontraktuesi për Autoritetin kontraktues. Të gjitha variacionet e kontratës duhet të respektojnë parimet e përgjithshme të definuara në udhëzuesin praktik për procedurat e kontratës të financuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Neni 23 Suspendimi

- 23.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Kontraktuesin që të pezullojë:
- a) prodhimin e Punëve;
 - b) dorëzimin e Punëve në vendin e pranimit në kohën e specifikuar për dorëzim në programin e realizimit ose, nëse nuk është specifikuar koha, në kohën kur ato duhet të dorëzohen; ose
 - c) instalimin e Punëve që janë dorëzuar në vendin e pranimit.
- 23.2 Gjatë pezullimit, Kontraktuesit do të mbrojnë dhe sigurojnë Punët e vendosura në depon e Kontraktuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse Punët janë dorëzuar në vendin e pranimit në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.
- 23.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:
- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë;
 - b) është i nevojshëm për arsye të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimit;
 - c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Kontraktuesit; ose
 - d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjese të saj përdorues nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.
- 23.4 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përveç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda [30] ditësh pas pranimit të urdhrit për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.
- 23.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Kontraktuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Kontraktuesi përkitazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.
- 23.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon [180] ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Kontraktuesit, Kontraktuesi, duke njoftuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me Punët brenda [30] ditësh, ose të ndërpresë kontratën.
- 23.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përmbajtjesore,
- 23.8 parregullsive ose mashtrimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtrime i atribuohen Kontraktuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë

pagesat ose mund t'i kthejë paratë që tashmë janë paguar, në proporcion me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtrimit.

- 23.9 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përmbajtjesore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtrimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përmbajtjesore ose parregullsitë do të jenë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

MATERIALET DHE MJESHTËRIA

Neni 24 Cilësia e Punëve

- 24.1 Punët duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.
- 24.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në Kushtet e veçanta duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga kontraktuesi për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrë e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuara në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në Punë.
- 24.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në Punë ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga kontraktuesi. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në Punë vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

Neni 25 Inspektimi dhe testimi

- 25.1 Kontraktuesi do të sigurojë që Punët të dorëzohen në vendin e pranimin me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e Punëve. Kontraktuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë.
- 25.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimin apo në vendet që janë specifikuar në Kushtet e veçanta.
- 25.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektiveve të tilla, kontraktuesi do të:
- I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;
 - Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;
 - T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.
- 25.4 Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, kontraktuesi mundet që, përveç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Kontraktuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuara si duhet të rezultateve të testit te Autoriteti kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.
- 25.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpërmendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë kontraktuesin ose ta miratojë certifikimin e kontraktuesit lidhur me këtë.
- 25.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'i japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohet se është gabim pas ri-testimit.
- 25.7 Gjatë realizimit të detyrave të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i

kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimit.

PAGESAT

Neni 26 Parime të përgjithshme - Pagesat

- 26.1 Pagesat do të bëhen në euro. Në Kushtet e veçanta do të paraqiten kushtet administrative ose teknike lidhur me pagesat e paradhënieve, pagesat e ndërmjetme dhe/ose pagesat përfundimtare që bëhen në pajtim me Kushtet e veçanta.
- 26.2 Pagesat që duhet të bëhen nga Autoriteti kontraktues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në formularin për identifikim financiar që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.
- 26.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se [30] ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës i specifikuar në Kushtet e veçanta. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.
- 26.4 Periudha prej [30]-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Kontraktuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Kontraktuesi do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda [15] ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.
- 26.5 Pagesat do të behen :PAGESAT BËHEN PAS FURNIZIMEVE DHE PUNEVE TE KRYERA SIPAS SITUACIONIT TE NENSHKRUARA NGA ORGANI MBIKQYRES.
- 26.8 Obligimet për pagesë të Autoritetit kontraktues sipas kësaj kontrate do të ndërpriten më së shumti pas [18] muajsh pas përfundimit të periudhës së ekzekutimit të detyrave, përveç nëse kontrata përfundon në pajtim me këto Kushte të përgjithshme.
- 26.9 Përveç nëse parashihet ndryshe në Kushtet e veçanta, kontrata do të jetë me çmime fikse, dhe çmimet nuk do të rishikohen, në përjashtim të çmimeve që i nënshtrohen ndryshimeve në bersën përkatëse të artikujve.
- 26.10 Kontraktuesi merr përsipër t'i kthejë Autoritetit kontraktues të gjitha shumat që paguhën më tepër sesa shuma përfundimtare brenda [30] ditësh pas pranimit të kërkesës për këtë. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të kthejë pagesën brenda afatit të dhënë nga Autoriteti kontraktues, Autoriteti kontraktues mundet (përveç nëse Kontraktuesi është departament qeveritar ose organ publik i Kosovës) ta rrisë shumën e obligimit duke shtuar interes me normën e zbritjes, në ditën e parë të muajit në të cilin skadon afati kohor, plus [tri e gjysmë] pikë përqindjeje. Interesi automatikisht do të krijohet gjatë kohës që kalon ndërmjet datës së fundit për pagesë të dhënë nga Autoriteti kontraktues (që nuk përfshihet), dhe datës në të cilën bëhet pagesa (që përfshihet). Të gjitha pagesat e pjesshme do të mbulojnë së pari interesin e krijuar në këtë mënyrë.

Shumat që i kthehen Autoritetit kontraktues mund të kompensohen me cilat do shuma që duhet t'i paguhën Kontraktuesit. Kjo nuk do të ndikojë në të drejtën e palëve për t'u marrë vesh për pagesë në këste. Provizioni bankar që shkaktohet nga kthimi i shumave Autoritetit kontraktues do të paguhet plotësisht nga Kontraktuesi.

Neni 27 Pagesat për palët e treta

- 27.1 Urdhrrat për pagesë për palët e treta mund të zbatohen vetëm pasi të bëhet bartja e detyrave në pajtim me Nenin 5. Autoriteti kontraktues do të lajmërohet për këtë bartje.
- 27.2 Njoftimi i përfituesve për këtë bartje do të jetë përgjegjësi e plotë e Kontraktuesit.
- 27.3 Në rast se prona e Kontraktuesit është e lidhur me obligim ligjor dhe kjo ndikon në realizimin e pagesave për të sipas kontratës, si dhe pa paragjykim ndaj afatit kohor të dhënë në Kushtet e veçanta, Autoriteti kontraktues do të ketë 30 ditë që t'i rifillojë pagesat për Kontraktuesin, duke filluar nga dita kur merr njoftim për tërheqjen definitive të pengesës për pagesë.

Neni 28 Vonesa e pagesës

- 28.1 Autoriteti kontraktues do t'i paguajë Kontraktuesit shumën e obligimit brenda 30 ditësh pas datës në të cilën është regjistruar pagesa e pranueshme, në pajtim me Nenin 43 të këtyre Kushteve të përgjithshme. Kjo periudhë kohe do të fillojë të llogaritet nga momenti i aprovimit të këtyre dokumenteve nga departamenti kompetent i përmendur në Nenin 43 të Kushteve të veçanta. Këto dokumente do të aprovohen ose në mënyrë të hapur ose të heshtur, në mungesë të reagimeve me shkrim në [30] ditë pas pranimit të tyre të shoqëruar me dokumentet e kërkuara.
- 28.2 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 28.1, Kontraktuesi mundet që, brenda [dy muajsh] pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për

pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

- 28.3 Të gjitha mospagesat pas [90] ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 28.1 do t'i japin të drejtë Kontraktuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej [30] ditësh për Autoritetin kontraktues.

PRANIMI DHE MIRËMBAJTJA

Neni 29 Dorëzimi

- 29.1 Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Punët në pajtim me kushtet e kontratës. Punët do të jenë në përgjegjësi të Kontraktuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.
- 29.2 Kontraktuesi do t'i paketojë Punët ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, ekspozimin në temperatura ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe peshat duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të Punëve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë transitit.
- 29.3 Paketimi, shënimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në Kushtet e veçanta, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.
- 29.4 Asnjë Shërbim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimit derisa kontraktuesi të ketë pranuar urdhrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimit të të gjitha Punëve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës. Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë kërkesën e Kontraktuesit brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se e ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.
- 29.5 Secili dorëzim duhet të shoqërohet me një deklaratë të përgatitur nga kontraktuesi. Kjo deklaratë do të jetë siç është e specifikuar në Kushtet e veçanta.
- 29.6 Secili paketim do të shënohet qartë në pajtim me Kushtet e veçanta.
- 29.7 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i Punëve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës, dhe faturat dhe dokumentet tjera që janë specifikuar në Kushtet e veçanta, i janë dorëzuar Autoritetit kontraktues. Atëherë kur Punët janë dorëzuar në një zyrë të Autoritetit kontraktues, ky e fundit do ta mbajë përgjegjësinë e ruajtjes, në pajtim me kërkesat e ligjit që zbatohen për kontratën, gjatë kohës që kalon ndërmjet dorëzimit për depozitim dhe pranimit.

Neni 30 Operacionet e verifikimit

- 30.1 Punët nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Kontraktuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të punëve.
- 30.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të Punëve dhe para se të merren Punët, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:
- heqjen nga vendi i pranimit, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdhër, të të gjitha Punëve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
 - zëvendësimin e tyre me Punë të mira dhe të përshtatshme;
 - heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjeshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshtërinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës kontraktuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontratën;
 - që puna e bërë ose punët e dorëzuara apo materialet e përdorura nga kontraktuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontratën, ose që Punët apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.
- 30.3 Kontraktuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuara. Nëse Kontraktuesi nuk vepron sipas këtyre urdhrave, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjerë për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj, Autoriteti kontraktues do t'i zbresë nga paratë që do të paguhet ose të cilat do të bëhen obligim për t'u paguar Kontraktuesit.
- 30.4 Punët që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset Punëve të refuzuara. Shenja nuk duhet të jetë e atillë që t'i ndryshojë ato, apo të ndikojë në vlerën e tyre komerciale. Punët e refuzuara kontraktuesi do t'i heqë nga vendi i pranimit, nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoriteti kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do të hiqen me të drejtë me shpenzim dhe me rrezik

të kontraktuesit. Të gjitha punët që përfshijnë materialet e refuzuara do të refuzohen.

- 30.5 Dispozitat e Nenit 30 nuk do të ndikojnë në të drejtën e Autoritetit kontraktues për të kërkuar zbatimin e Nenit 21, dhe në asnjë mënyrë nuk e lirojnë Kontraktuesin nga siguria ose nga obligimet tjera me kontratë.

Neni 31 Pranimi i përkohshëm

- 31.1 Punët do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.
- 31.2 Kontraktuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm atëherë kur Punët të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit të kontraktuesit do të veprojë sipas njëres nga këto më poshtë:
- t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar Punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
 - të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij e kërkon Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.
- 31.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë të pamundur që të vazhdohet me pranimin e Punëve gjatë periudhës së fiksuar për pranim të përkohshëm ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë për ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, në konsultim me kontraktuesin. Certifikata e pranimit ose e refuzimit do të përgatitet brenda [30] ditësh pas datës në të cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuari. Kontraktuesi nuk do të nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave për të evituar obligimin e paraqitjes së Punëve në një gjendje të përshtatshme për pranim.
- 31.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë Punët brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe, përveç në rastet kur certifikata e pranimit të përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë të pranimit përfundimtar. Në këtë rast, neni 34.2 më poshtë nuk vlen. Nëse Punët ndahen me kontratë në pjesë, Kontraktuesi do të ketë të drejtë të bëjë kërkesë për certifikatë të veçantë për secilën pjesë.
- 31.5 Në raste të dorëzimit të pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën për të dhënë pranim të pjesshëm e të përkohshëm.
- 31.6 Pas pranimit të përkohshëm të Punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 32 Obligimet për garanci

- 32.1 Kontraktuesi do të garantojë që Punët të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Për më tepër, kontraktuesi do të garantojë që asnjë nga Punët të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshhtëria, përveç deri në atë masë sa dizajni dhe materialet të kërkohen në specifikime, ose nga ndonjë veprim apo mosveprim, që mund të shkaktohet gjatë përdorimit të Punëve në kushtet që zbatohen në shtetin e Autoritetit kontraktues. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në Kushtet e veçanta.
- 32.2 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të Punëve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:
- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshhtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Kontraktuesi; ose
 - b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Kontraktuesit gjatë periudhës së garancisë; ose
 - c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.
- 32.3 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të Punëve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.
- 32.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë kontraktuesin. Nëse kontraktuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:
- a) të korrigojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej kontraktuesit ose nga të dy; ose

b) të ndërpresë kontratën.

- 32.5 Në raste emergjente, kur kontraktuesi nuk mund të gjendet menjëherë, ose nëse gjendet nuk është në gjendje t'i marrë masat që kërkohen, autoriteti kontraktues mund ta realizojë punën me shpenzime të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues do ta informojnë kontraktuesin sa më shpejt që të jetë praktike për veprimin e marrë.
- 32.6 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në Kushtet e veçanta dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë [365] ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm dhe mund të rifillojë në pajtim me Nenin 32.3.

Neni 33 Punët pas-shitjes

Punët pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në Kushtet e veçanta. Kontraktuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të Punëve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. Kushtet e veçanta mund të saktësojnë që Kontraktuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Kontraktuesi:

a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Kontraktuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës;

b) në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuara dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

Neni 34 Pranimi përfundimtar

- 34.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda [30] ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 32 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.
- 34.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.
- 34.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE NDËRPRERJA E SAJ

Neni 35 Shkelja e kontratës

- 35.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.
- 35.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:
- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.
- 35.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:
- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme
- Shuma dhe procedurat e këtyre dëmeve do të paraqiten në Kushtet e veçanta.
- 35.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 36 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

- 36.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Kontraktuesit shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:
- a) kur Kontraktuesi në mënyrë përmbajtjesore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Kontraktuesi dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkohet nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;

- c)Kontraktuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d)Kontraktuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e)Kontraktuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f)Kontraktuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- g)Kontraktuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- h)Kontraktuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
- i)Kontraktuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
- j)të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Kontraktuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- k)shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- l)Kontraktuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.
- 36.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Kontraktuesit. Detyrimi i Kontraktuesit për të shtyrë përbushjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.
- 36.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë kontraktuesin që të ndër marrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e Punëve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.
- 36.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Kontraktuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi Punët e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Kontraktuesit dhe parave që i ka borxh Kontraktuesi Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.
- 36.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Kontraktuesin derisa të jenë përfunduar Punët, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Kontraktuesi koston ekstra, nëse ka, të Punëve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Kontraktuesit para ndërprerjes së kontratës.
- 36.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Kontraktuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të Kushteve të veçanta.
- 36.7 Kjo kontratë automatikisht do të ndërpritet nëse ajo nuk ka shkaktuar pagesa në tri vitet pas nënshkrimit të saj.
- Neni 37 Ndërprerja nga ana e Kontraktuesit
- 37.1 Kontraktuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:
- nuk arrin t'i paguajë Kontraktuesit shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit të dhënë në Kushtet e veçanta;
 - vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
 - e pezullon dorëzimin e Punëve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se [180] ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Kontraktuesit.
- 37.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit.
- 37.3 Në rast të ndërprerjes së tillë, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Kontraktuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Kontraktuesit.

Neni 38 Forca madhore

- 38.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit të dhënies ose datës kur kontrata hyn në fuqi, cilado që të jetë më herët.
- 38.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.
- 38.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 21 dhe 36, Kontraktuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 28 dhe 37, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Kontraktuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.
- 38.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, kontraktuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Kontraktuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.
- 38.5 Nëse kontraktuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 38.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.
- 38.6 Nëse rrethanat e forcës madhore kanë ndodhur dhe vazhdojnë për një periudhë prej [180] ditësh, atëherë, pa marrë parasysh ndonjë zgjatje të kohës për përmbushjen e kontratës që Kontraktuesi me arsye mund ta ketë lejuar, secila palë do të ketë të drejtë t'i shërbejë tjetrës me [30] ditë paralajmërim për ndërprerje të kontratës. Nëse, pas skadimit të periudhës prej [30] ditësh, situata e forcës madhore ende vlen, kontrata do të ndërpritet dhe, sipas ligjit që e qeveris kontratën, palët do të lirohen nga obligimi i realizimit të mëtutjeshëm të kontratës.

Neni 39 Vdekja

- 39.1 Në rast se Kontraktuesi është person fizik, kontrata ndërpritet automatikisht nëse ai person vdes. Megjithatë, Autoriteti kontraktues do t'i kontrollojë propozimet e bëra nga trashëgimtarët e përfituesve nëse ata kanë shprehur dëshirën e tyre për ta vazhduar kontratën. Vendimi i Autoritetit kontraktues do t'i përcillet personave përkatës brenda [30] ditësh pas pranimit të propozimit të tillë.
- 39.2 Në rast se Kontraktuesi përbëhet nga një numër personash fizikë dhe një ose më shumë prej tyre vdesin, do të vendoset me marrëveshje një raport ndërmjet palëve në progresin e kontratës, ndërsa Autoriteti kontraktues do të vendosë nëse do ta ndërpresë ose ta vazhdojë kontratën në pajtim me ndërmarrjen e bërë nga të mbijetuarit dhe trashëgimtarët ose përfituesit, sipas rastit.
- 39.3 Në rastet e parapara në Nenet 39.1 dhe 39.2, personat që ofrojnë të vazhdojnë ta realizojnë kontratën do ta njoftojnë Autoritetin kontraktues për këtë brenda [15] ditësh pas datës së vdekjes.
- 39.4 Personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe veç e veç të obliguar për realizimin e mirë të kontratës në të njëjtën masë sa edhe Kontraktuesi fillestar. Vazhdimi i kontratës do t'i nënshtrohet rregullave që kanë të bëjnë me themelimin e garancisë sipas Nenit 11.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 40 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

- 40.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda [15] ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë [30] ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.
- 40.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes [shëno institucionin]. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda [30] ditësh pas fillimit të procedurës së

pajtimin, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 41 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda [30] ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a)ose vendim nga gjyqi

b)ose vendim arbitrimi

në pajtim me Kushtet e veçanta të kësaj kontrate.

KLAUZOLAT ETIKE

Neni 42 Klauzolat etike

- 42.1 Të gjitha përpjekjet nga një kandidat ose ofertues për të marrë informata sekrete, për të hyrë në marrëveshje jo të ligjshme me konkurruesit ose për të ndikuar te komisioni apo Autoriteti kontraktues gjatë procesit të ekzaminimit, qartësisht, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve do të çojë në refuzim të tenderit të tij.
- 42.2 Pa autorizim paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues, Kontraktuesi dhe personeli i tij ose ndonjë kompani tjetër me të cilën Kontraktuesi është i lidhur apo i shoqëruar nuk mundet, as në bazë vartësie as nënkontraktuese, të japë punë tjera, të realizojë punë ose pajisje Shërbimi për kontratë.
- 42.3 Kjo ndalesë vlen edhe për ndonjë aktivitet tjetër të prokurimit publik që mundet, për shkak të natyrës së kontratës, të shkaktojë konflikt interesash nga ana e Kontraktuesit.
- 42.4 Kur paraqet një ofertë, ofertuesi duhet të deklarojë që ai nuk është i ndikuar nga asnjë konflikt potencial interesash dhe nuk ka ndonjë lidhje të veçantë me ofertuesit tjerë apo palët e përfshira në aktivitetin e prokurimit. Nëse shfaqet një situatë e tillë gjatë realizimit të kontratës, Kontraktuesi menjëherë duhet ta informojë Autoritetin kontraktues.
- 42.5 Kontraktuesi çdoherë duhet të veprojë në mënyrë të paanshme dhe si këshilltar i besuar në pajtim me kodin e mirësjelljes për profesionin e tij. Ai duhet të përmbahet nga dhënia e deklaratave publike për projektin apo punët pa aprovim paraprak nga Autoriteti kontraktues. Ai nuk mund ta bëjë Autoritetin kontraktues të marrë përsipër ndonjë gjë në asnjë mënyrë, pa pajtim paraprak me shkrim nga ai.
- 42.6 Gjatë kohës që zgjat kontrata, Kontraktuesi dhe personeli i tij do t'i respektojnë të drejtat njerëzore dhe do të veprojnë për të mos bie ndesh me zakonet politike, kulturore dhe religjioze në shtetin përfitues.
- 42.7 Kontraktuesi nuk mund të pranojë pagesë të lidhur me kontratën përveç asaj të paraparë në kontratë. Kontraktuesi dhe punëtorët e tij nuk duhet të ushtrojnë asnjë aktivitet as të pranojnë ndonjë favor që nuk është në pajtueshmëri me obligimet e tyre ndaj Autoritetit kontraktues.
- 42.8 Kontraktuesi dhe punëtorët e tij do të jenë të obliguar të mbajnë sekretin profesional gjatë tërë kohëzgjatjes së kontratës dhe pas përfundimit të saj. Të gjitha raportet dhe dokumentet e përgatitura apo të pranuar nga Kontraktuesi do të jenë sekrete.
- 42.9 Kontraktuesi do të shmanget nga çfarëdo marrëdhënie që ka gjasa ta komprometojë pavarësinë e tij ose të personelit të tij. Nëse Kontraktuesi pushon të jetë i pavarur, Autoriteti kontraktues mundet, pa marrë parasysh dëmin, ta ndërpresë kontratën pa njoftim të mëtutjeshëm dhe pa mundësi që Kontraktuesi të bëjë ankesë dhe të kërkojë kompensim.
- 42.10 Organi i Shqyrtimit të Prokurimit ka të drejtë të suspendojë ose anulojë kontratën nëse zbulohen praktika të korrupsionit të çfarëdo lloji në cilëndo fazë të procesit të dhënies së kontratës dhe nëse Autoriteti kontraktues nuk i merr të gjitha masat e duhura për të përmirësuar situatën. Për qëllime të kësaj dispozite, "praktika korrupsionit" janë ofrimi i ryshfetit, dhuratave, shpërblimeve në para ose "dhënies me përbindje" cilitdo person si nxitje ose si shpërblim për realizimin apo për mos bërjen e ndonjë veprimi që lidhet me dhënien e një kontrate apo implementimin e një kontrate që tashmë është nënshkruar me Autoritetin kontraktues.
- 42.11 Shpenzimet e tilla të pazakonshme komerciale janë përbindjet që nuk janë përmendur në kontratën kryesore ose që nuk dalin nga një kontratë e nënshkruar si duhet e që i referohet kontratës kryesore, përbindjet që nuk kthehen për punët aktuale dhe legjitime, përbindjet që nuk janë paguar si kthim për punët aktuale, përbindjet që i paguhen një vendi me tatime të favorshme, përbindjet që i paguhen pranuesit që nuk është i identifikuar qartë ose përbindjet që i paguhen një kompanie prapa së cilës fshihet ndonjë kompani tjetër.
- 42.12 Kontraktuesi merr përsipër që, sipas kërkesës, t'i japë Organit të Shqyrtimit të Prokurimit të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me kushtet e ekzekutimit të kontratës. OSHP mund të bëjë çfarëdo kontrollimesh të dokumenteve ose kontrole të atypëratyshme, për të cilat ajo konsideron se janë të nevojshme për të gjetur dëshmi në rastet e shpenzimeve komerciale të dyshimta dhe të pazakonshme.

Neni 43 Dënimet administrative dhe financiare

- 43.1 Pa e paragjykuar zbatimin e dënimeve të parapara në kontratë, Kontraktuesi që është shpallur fajtor për deklaratë të rrejshme ose që është zbuluar se seriozisht nuk ka arritur të plotësojë obligimet e veta kontraktuese në ndonjë procedurë të mëhershme të prokurimit, do të përjashtohet nga të gjitha kontratat dhe grantet e financuara nga buxheti i komunitetit për më së shumti dy vite nga koha kur është përcaktuar se ka pasur shkelje, ndërsa pas konfirmimit pas një procedure gjyqësore kontestimore me Kontraktuesin. Kontraktuesi mund të prezantojë argumentet e veta kundër dënimit brenda [30] ditësh pas njoftimit të dënimit me letër të regjistruar dhe me njoftim të pranimit ose me ndonjë mënyrë apo mjet tjetër ekuivalent. Në mungesë të reagimit nga ana e Kontraktuesit, ose të tërheqjes së dënimit nga OSHP brenda [30] ditësh nga pranimi i argumenteve të Kontraktuesit kundër kësaj, vendimi që e imponon dënimin do të bëhet i zbatueshëm. Kjo periudhë mund të zgjatet deri në tri vite në rast se shkelja përsëritet brenda pesë vitesh pas shkeljes së parë.
- 43.2 Nëse Kontraktuesi zbulohet se ka pasur dështim serioz që t'i plotësojë obligimet e veta kontraktuese, ai do të pësojë dënime financiare që përfaqësojnë [10] % të vlerës totale të kontratës në fjalë. Kjo përqindje mund të rritet në [20] % në rast të përsëritjes së shkeljes brenda pesë vitesh pas shkeljes së parë.

Neni 44 Kontrolllet dhe auditimet

- 44.1 Autoriteti kontraktues do t'i lejojë Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës të verifikojë, duke ekzaminuar dokumentet ose përmes kontrolleve të befasishme, implementimin e kontratës dhe të bëjë një auditim të plotë, nëse është i nevojshëm, në bazë të dokumenteve plotësuese për llogaritë, dokumentet e kontabilitetit dhe ndonjë dokument tjetër që është me rëndësi për financimin e kontratës. Këto inspektime mund të bëhen edhe deri në [7 vite] pas pagesës finale.

PJESA E KONTRATËS - III - KUSHTET E VEÇANTA

PËRMBAJTJA

Këto kushte përforcojnë dhe plotësojnë, nëse është e nevojshme, Kushtet e përgjithshme që udhëheqin kontratën. Përveç nëse Kushtet e veçanta lejojnë ndryshe, Kushtet e përgjithshme mbeten plotësisht të zbatueshme. Numërimi i neneve të Kushteve të veçanta nuk është konjektiv por i përmbahet numërimit të neneve në Kushtet e përgjithshme. Në raste të veçanta, dhe me autorizim të departamenteve kompetente të Komisionit, mund të përfshihen edhe klauzola tjera për të mbuluar situata specifike.

Neni 1. Përkufizimet	Neni 23. Suspensimi
Neni 2. Gjuha dhe ligji i aplikueshëm	Neni 24. Cilësia e Punëve
Neni 3. Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës	Neni 25. Inspektimi dhe testimi
Neni 4. Komunikimi	Neni 26. Parime të përgjithshme
Neni 5. Transferimi	Neni 27. Pagesat për palët e treta
Neni 6. Nën-kontraktimi	Neni 28. Vonesa e pagesës
Neni 7. Dhënia e dokumenteve	Neni 29. Dorëzimi
Neni 8. Ndihma lidhur me rregulloret vendore	Neni 30. Operacionet e verifikimit
Neni 9. Obligimet e përgjithshme	Neni 31. Pranimi i përkohshëm
Neni 10. Prejardhja	Neni 32. Obligimet për garanci
Neni 11. Siguria e ekzekutimit	Neni 33. Punët pas-shitjes
Neni 12. Sigurimi	Neni 34. Pranimi përfundimtar
Neni 13. Programi i realizimit	Neni 35. Shkelja e kontratës
Neni 14. Skicat e Kontraktuesit	Neni 36. Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues
Neni 15. Mjaftueshmëria e çmimeve të tenderit	Neni 37. Ndërprerja nga ana e Kontraktuesit
Neni 16. Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën	Neni 38. Forca madhore
Neni 17. Patentat dhe licencat	Neni 39. Vdekja
Neni 18. Rendi i fillimit	Neni 40. Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve
Neni 19. Kontrata të përmbushet në afatin e caktuar	Neni 41. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore
Neni 20. Zgjatja e periudhës së ekzekutimit	Neni 42. Klauzolat etike
Neni 21. Vonesat e ekzekutimit	Neni 43. Dënimet administrative dhe financiare
Neni 22. Variacionet	Neni 44. Kontrollat dhe auditimet

Neni 1. Përkufizimet

Titulli: Furnizim me PAISJE për Subvencionimin e Fermerve me Mekanizëm Bujqësor-Rotofreza 1.8m gjersi-DBZHR Nr i prokurimit: 642-21-3639-1-2-1;Nr i brendshëm 642/21/031/121.

Sipas Kushteve te pergjithshme te Kontrates neni 1.

Neni 2. Gjuha dhe Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i Prokurimit Publik dhe Ligjet tjera të aplikueshme ne Kosovë zbatohet për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës.

2.2 Gjuha që përdoret do të jetë: Shqipe

Neni 3. Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

Sipas nenit 4, Pjesa I (e parë) e Kontratës.

Neni 4. Komunikimi

Emri i AK:	KOMUNA E MITROVICËS	Personi kontaktues:	Bedri BAJRAMI
e-mail	prokurimi.mitrovica@rks-gov.net	e-mail:	bedri_bajrami@rks-gov.net
ZPP	HAXHIMET FERATI	Menaxher i Kontrates	Bedri Bajrami bedri.bajrami@rks-gov.net
Adresa :	Vilezrit Dragaj	Kodi postar	40 000
Qyteti:	MITROVICË	Regjioni	Mitrovicë
Telefoni:	038/200-42 045	Fax	N/A

Emri i OE:	ANA CO SH.P.K., Mexhit Mustafa, 21010, RAHOVEC	Personi kontaktues:	Ismail Oruqi
		e-mail:	anaco.shpk@gmail.com
Adresa :	Rahovec, Kosovë.	Kodi postar	21010
Qyteti:	Rahovec,	Regjioni	Rahovec
Telefoni:	+383 45 111 306	Fax	N/A

Komunikimi mes palëve do te behet ne formen e shkruar ne leter ose me post elektronike, faks e ne pamundesi te komunikimeve te tilla edhe me telefon.

Neni 5. Transferimi

Transferimi i Kontratës nga ana e Kontraktorit te ndonjë palë tjetër nuk lejohet pa pëlqimin e Autoritetit Kontraktues. Por edhe nëse merret pëlqimi nga Autoriteti Kontraktues ai do të jetë valid vetëm për pikat e cekura sipas nenit 5, Kushteve të Përgjithëshme të Kontratës.

Titulli: Furnizim me PAISJE për Subvencionimin e Fermerve me Mekanizëm Bujqësor-Rotofreza 1.8m gjersi-DBZHR Nr i prokurimit: 642-21-3639-1-2-1;Nr i brendshëm 642/21/031/121.

Neni 6. Nën -kontraktimi

Nën-kontraktimi lejohet vetën deri në vlerën prej 40% të vlerës së përgjithëshme të kontratës dhe me këtë rast duhet të prezantohet marrveshja e nënshkruar mes kontraktorit dhe nën-kontraktorit, ku definohen aspektet dhe vëllimi i nën-kontraktimit.

Neni 7. Dhënia e dokumenteve

Sipas nenit 7, të Kushteve të Përgjithëshme të Kontratës - Pjesa II (e dytë) e Kontratës.

Neni 8. Ndihma lidhur me rregulloret vendore

Autoriteti Kontraktues obligohet që me kërkesën e Kontraktorit, në afat sa më të shkurt, atë ta pajisë me Ligje dhe Rregullore vendore të cilat janë të domosdoshme për realizimin e kontratës pa pengesa, ose ta drejtojë atë në adresën e saktë ku më së shpejti mund t'i realizojë kërkesat e tijë.

Neni 9. Obligimet e përgjithshme

Kontraktuesi duhet ti përmbahet ofertës së dhënë si dhe specifikimeve në dosjen e tenderit si dhe obligimeve sipas nenit 9 të Kushteve të Përgjithëshme të Kontratës.

Neni 10. Prejardhja (Nëse Aplikohet)

Mallrat e përdorur gjatë punës duhet të jenë të pajisur me certifikatë e cila dëshmon kualitetin dhe prejardhjen, në të kundërtën nuk do të pranohet nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 11. Sigurimi i ekzekutimit të kontratës

Sigurimi i ekzekutimit 10 % Të SHUMES TOTALE TË KONTRATËS NË AFAT 3 MUAJ PAS DATËS SE NENSHKRIMIT TË KONTRATËS.

Neni 12. Sigurimi

Nëse aplikohet sigurimi i mallit atëherë duhet të bëhet në pajtim me nenin 12 të Kushteve të Përgjithëshme të Kontratës.

Neni 13. Programi i realizimit

Kontraktori duhet t'i kryej të gjitha obligimet në pajtim me planin dinamik/afatet kohore prej momentit kur leshohet vendimi për zbatim nga organet komunale ne afat 3 ditëve pune të cekur në ofertën e tij, në dosjen e tenderit apo të aprovuar nga Menaxheri i Projektit për çdo kërkesë të pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14. Skicat e Kontraktuesit

Nëse nga Autoriteti Kontraktues kërkohen skica, vizatime apo mostra të produkteve të cilat duhet duhet liferuar, të gjitha këto kontraktori obligohet ti dorëzoj ashtu siç është specifikuar në dosjen e tenderit.

Neni 15. Mjaftueshmëria e çmimeve të tenderit

Autoriteti Kontraktues do të nënshkruaj kontratën vetëm pasi të vërtetohet se oferta e kontraktorit potencial është e pranueshme dhe në vete përmban të gjitha obligimet (DDP). Për çfarëdo ndryshimesh të cilat nuk mund të arsyetohen shpenzimet shtesë i bartë vet Kontraktori.

Neni 16. Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

Të gjitha obligimet lidhur me tatimin dhe doganën per mallin që duhet liferuar i bartë Kontraktori në pajtim me ligjet e aplikueshme ne vend.

Titulli: Furnizim me PAISJE për Subvencionimin e Fermerve me Mekanizëm Bujqësor-Rotofreza 1.8m gjersi-DBZHR Nr i prokurimit: 642-21-3639-1-2-1;Nr i brendshëm 642/21/031/121.

Neni 17. Patentat dhe licencat

Të gjitha licencat dhe patentet e nevojshme për përmbylljen e kontratës me sukses janë obligim i kontraktorit.

Neni 18. Rendi i fillimit

Procedura e punës duhet koordinuar mes Menaxherit të Projektit dhe Kontraktorit ashtu që të plotësohen konditat e pranimit sipas rendit me prioritet/kapacitetit punues.

Neni 19. Kontrata të përbushet në afatin e caktuar

Afatet për përbushjen e Kontratës është 60 DITË PUNE liferimet fillojnë brenda 5 ditëve pas nënshkrimit të kontratës ajo duhet të fillojë të zbatohet në tërësi.

Neni 20. Zgjatja e afatit për përbushje të kontratës

Zgjatja e afateve të realizimit të kërkesave(kontrates) behet në koordinim me Autoritetin Kontraktues (Projekt Menaxherit) dhe Kontraktorit, me një arsytim të plotë të dorëzuar me shkrim nga ana e Kontraktorit dhe të aprovuar nga Projekt Menaxheri.

Neni 21. Vonesat në ekzekutim

Për çfarëdo vonesash të cilat nuk pranojnë nga Menaxheri i Projektit Autoriteti Kontraktues do t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, ose [5/100] të vlerës së punëve të pa dorëzuara/realizuar deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.

Neni 22. Variacionet

Çdo variacion i mundshëm duhet të jetë në pajtim me nenin 22 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës mirëpo në asnjë mënyrë nuk guxon të tejkalon vlerën prej 10% nga vlera totale e kontratës.

Neni 23. Suspendimi

Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën që për shkak të arsyeshme të pezullojë liferimin e caktuar duke u bazuar në nenin 23 të KPK, brenda afatit të vlefshmërisë së ofertës apo të vlefshmërisë së sigurimit të ekzekutimit.

Neni 24. Cilësia e Punëve

Punët duhet të jenë në pajtim me specifikimet e kërkuara në dosje të tenderit dhe t'i përbushin kushtet dhe standardet për punët të cilat janë objekt i kontratës.

Neni 25. Inspektimi dhe testimi

Inspektimi dhe testimi i punëve behet nga Projekt Menaxheri/Komisioni pranues për çdo material dhe periudhë të punës.

Neni 26. Parime të përgjithshme - Pagesat

PAGESAT BËHEN SIPAS FURNIZIMEVE TË KRYERA DHE SI DHE SITUACIONIT DHE RAPORTEVE TË APROVUARA DHE TË NËNSHKRUARA NGA ORGANI MBIKQYRES DHE MENAXHERI I PROJEKTIT.

Neni 27. Pagesat për palët e treta

Nëse aplikohen pagesat për palët e treta do të bëhen në pajtim me nenin 27 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës.

Neni 28. Vonesa e pagesës

Nëse kontraktuesi nuk ka ndalesa të cekura sipas nenit 43 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, çdo vonesë të pagesës nga ana e Autoritetit Kontraktues e cila nuk është kryer në pajtim me nenin 26 të KVK dhe KPK, mund të realizojë sipas nenit 28 të KPK

Titulli: Furnizim me PAISJE për Subvencionimin e Fermerve me Mekanizëm Bujqësor-Rotofreza 1.8m gjersi-DBZHR Nr i prokurimit: 642-21-3639-1-2-1;Nr i brendshëm 642/21/031/121.

Neni 29. Dorëzimi

Dorëzimi i punëve të cilat janë objekt i kontratës behet nga ana e kontraktorit të Menaxheri i projektit i caktuar nga Autoriteti Kontraktues. Dorëzimi duhet të kryhet në pajtim me nenin 13 të Kushteve të Veçanata të Kontratës. Çdo dorëzim duhet të bëhet me fletëdërgesë.

Neni 30. Operacionet e verifikimit

Autoriteti Kontraktues do të bëjë verifikimin dhe testimin e punëve me rastin e dorëzimit nga ana e kontraktorit. Ky verifikim dhe testim nënkupton përmbajtjen/përshatjen e punëve të liferuara me specifikat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe/apo certifikatat/atestet e dorëzuara nga kontraktuesi.

Neni 32. Obligimet për garanci

Garancioni vlen deri në ditën e pranimit teknik të punimeve nga Komisioni i pranimit teknik, para pranimit teknik të gjitha dobesit e shfaqura duhet të rregullohen për të bërë pranimit teknik të punimeve.

Neni 31. Pranimi i përkohshëm

Pranimi i përkohshëm mund të bëhet nëse drejtpërdrejtë ndikojnë rrethanat e punës apo deponimit dhe në koordinim me Kontraktorin dhe Autoritetin Kontraktues dhe në këtë rast çdo pranimit i tillë duhet të pranohet si i përkohshëm dhe duhet të leshohet certifikatë e pranimit/dorëzimit të përkohshëm, mirëpo çdo gjë duhet të jetë pajtim me nenin 30 të KVK dhe nenin 31 të KPK.

Neni 33. Punët pas-shitjes (Nuk aplikohen)

Shërbimet pas-shitjes nënkuptojnë: Pjesët rezervë..... etj .

Neni 34. Pranimi përfundimtar

Pranimit përfundimtar bëhet pas përfundimit të punimeve të cilat janë pranuar përkohësisht sipas nenit 31 të KVK) dhe pasi të jenë kryer verifikimet, testimet dhe pranimit me raporte zyrtare të nënshkruara nga Menaxheri i projektit/Komisioni pranues. Punët të cilat nuk kanë pranimit përfundimtar nuk konsiderohen të pranuar. Ky nen plotësohet me nenin përkatës nga KPK.

Neni 35. Shkelja e kontratës

Mos-përmbushja e kontratës nga ana e Kontraktorit sipas: afateve, sasisë, kualitetit etj, nënkupton se kontraktori ka dështuar në realizimin e kontratës në termet e caktuara dhe do të aplikohen masa ndëshkuese në pajtim me Kontratën dhe Ligjin e Prokurimit.

Neni 36. Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

Nëse për arsye të caktuara (të cekura në nenin 36 të KPK) kontrata nuk është e realizueshme, Autoriteti Kontraktues me paralajmërim prej 7 ditësh mund ta ndërprejë Kontratën me Kontraktorin, mirëpo paraprakisht duhet siguruar se Kontraktori e ka pranuar njoftimin me kohë.

Neni 37. Ndërprerja nga ana e Kontraktuesit

Nëse për arsye të caktuara (të cekura në nenin 37 të KPK) kontrata nuk është e realizueshme, Kontraktori me paralajmërim prej 14 ditësh mund ta ndërprejë Kontratën me Autoritetin Kontraktues, mirëpo paraprakisht duhet siguruar se Autoriteti Kontraktues e ka pranuar njoftimin me kohë.

Neni 38. Forca madhore

Sipas nenit 38 të Kushteve të Përgjithëshme të Kontratës.

Neni 39. Vdekja

Sipas nenit 39 të Kushteve të Përgjithëshme të Kontratës.

Neni 40. Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

Për çfarëdo mosmarrëveshjeje në mes palëve kontraktuese palët duhet të komunikim me shkrim duhet të njoftohen dhe

Titulli: Furnizim me PAISJE për Subvencionimin e Fermerve me Mekanizëm Bujqësor-Rotofreza 1.8m gjersi-DBZHR Nr i prokurimit: 642-21-3639-1-2-1;Nr i brendshëm 642/21/031/121.

në afat prej 15 ditësh të gjejnë zgjidhje për mosmarrëveshjet e cekura. Në rast se nuk mund të zgjidhen këto mosmarrëveshje në këtë afat, atëherë duhet që në afatin shtesë prej 15 ditësh të caktohen komisionet dypalëshe dhe vendimet e këre takimeve duhet të mbulohen me procesverbale zyrtare.

Neni 41. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

Nëse nuk është e mundur që mosmarrëveshjet mes palëve kontraktuese të zgjedhen në mënyrë miqësore atëherë zgjedhja e mosmarrëveshjeve duhet të transferohet në menyrë institucionale përmes gjykatave kompetente.

Neni 42. Klauzolat etike

Sipas nenit 42 të Kushteve të Përgjithëshme të Kontratës.

Neni 43. Dënimet administrative dhe financiare

Nëse Kontraktuesi zbulohet se ka pasur dështim serioz që t'i plotësojë obligimet e veta kontraktuese, ai do të pësojë dënime financiare sipas nenit 21 të KVK, deri në [10] % të vlerës totale të kontratës në fjalë. Kjo përqindje mund të rritet në [20] % në rast të përsëritjes së shkeljes brenda pesë vitesh pas shkeljes së parë.

Neni 44. Kontrolllet dhe auditimet

Autoriteti kontraktues do t'i lejojë Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës të verifikojë, duke ekzaminuar dokumentet ose përmes kontrolleve të befasishme, implementimin e kontratës dhe të bëjë një auditim të plotë, nëse është i nevojshëm, në bazë të dokumenteve plotësuese për llogaritë, dokumentet e kontabilitetit dhe ndonjë dokument tjetër që është me rëndësi për financimin e kontratës. Këto inspektime mund të bëhen edhe deri në [7 vite] pas pagesës finale.

Neni 45. Klauzola shtesë

Në rast të çfarëdo paqartësish Kushtet e Veçanta plotësohen me Kushtet e Përgjithëshme të Kontratës dhe Ligjin e Prokurimit Publik.

Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit: 16/07/2021

SPECIFIKIMI I QMIMEVE


Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE- Titulli Furnizim me PAISJE për Subvencionimin e Fermerve me Mekanizëm Bujqësor-DBZHR. Nr i prok: 642/21/3639/121; Nr i brendsh: 642/21/031/121

Lloji i artikullit Furnizim me PAISJE për Subvencionimin e Fermerve me Mekanizëm Bujqësor -DBZHR.	Njësia matse	Sasia	Qmimi njësi pa TVSH	Qmimi njësi me TVSH	TOTALI Gjithsejt
<p>ROTOFREZA min 1.8 metra gjerësi Me specifikat si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Gjersia punuese min 1.8 m -Shpejtesia e operimit min 540 rpm -Numri rrotullues i thikave min 210 rpm -Numri total i thikave min 54 cope -Tipi i thikave TIPI C -Thellsia punuese min 8 cm deri 12 cm -Fuqia minimale e kerkuar min 40 kf -Pesha min 315 kg neto -Syri magjik i tejdkshem per verfikimin e vajit -Me kardan Adekuat 			815 €	815 €	44,825.00 €
1					44,825.00 €
Totali i Përgjithshëm:					44,825.00 €

SPECIFIKIMI I QMIMEVE

Pjesa II. PËRSHKRIMI I QMIMEVE- Titulli Furnizim me PAISJE për Subvencionimin e Fermerve me Mekanizëm Bujqësor-DBZHR. Nr i prok:
642/21/3639/121; Nr i brendsh: 642/21/031/121

Vërejtje: Përmbajtje specifike teknike të detyrueshme në Anexin 1 të

DENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	ANA CO SH.P.K.
EMRI DHE MBIEMRI I PERFAQESUESIT TE O.E.	BELKIZE HAXHIJAJHA
NENSHKRIMI:	
DATA:	01.07.2021
VULA:	